

Intervistë e Ministrit Ferati, dhënë gazetës ” Lajm”

Prishtinë, 16 dhjetor –

Fillimi i punës së komunave të reja, sipas ministrit Sadri Ferati, do të zbehë dhe shpërbëjë strukturat paralele, të cilat sipas tij, nuk mund t’u sjellin asgjë të mirë serbëve të Kosovës. Sipas ministrit Ferati, deri në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, komunat e reja do të bëhen funksionale dhe do të fillojnë t’u ofrojnë shërbime qytetarëve lokalë. Pjesa më e vështirë e procesit të decentralizimit, krijimi i komunës së Mitrovicës së Veriut, do të fillojë të implementohet në momentin kur të krijohej kushtet dhe se, sipas ministrit, interesimi për këtë projekt nga ana e serbëve është në rritje

Prishtinë, 16 dhjetor – Procesin e implementimit të decentralizimit, i cili u jetësua me zgjedhjet e 15 nëntorit, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Sadri Ferati, në një intervistë për “Lajm” e quan të suksesshëm. Sipas tij, zgjedhjet lokale kanë marrë një besim të lartë dhe janë zhvilluar sipas standardeve më të larta. “Ne vlerësojmë se kanë qenë të suksesshme. Siç dihet, që në fillim të këtij viti ne kemi filluar me bartjen e kompetencave dhe ajo ka qenë pjesa kryesore e decentralizimit. Tani jemi në fund të bartjes së të gjitha kompetencave ashtu siç parashikohen me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe njëkohësisht pas një pune shumë të madhe të të gjithëve, ne kemi krijuar një kontakt të fuqishëm me të gjithë qytetarët. Vetë mbajtja e zgjedhjeve lokale i ka arsyetuar pritjet tona, se do të ketë progres në decentralizimin territorial dhe themelimin e tri komunave të reja, Graçanicës, Kllokotit dhe Ranillukut”, tha ministri Ferati. Sipas tij, dalja më e madhe në zgjedhje sesa herën e kaluar ka ardhur si rezultat i programeve më atraktive që kanë bërë kandidatët për kryetarë komunash, përfshirë këtu edhe komunat e reja. “Në programet e kryetarëve, si rezultat i decentralizimit, në këto zgjedhje ka qenë në program edhe çështja e fabrikave të ujit, grumbullimi i mbeturinave, pastërtia në qytet, sipërfaqet e gjelbëruara, pra të gjitha këto kanë ndikuar në program konkret për qytetarët. Marrë në përgjithësi, bindja ime është se Kosova kaloi edhe një test shumë të rëndësishëm të demokracisë, mbajti zgjedhje të lira, implementoi ligjet e veta dhe tani konsideroj se kjo është diku mbi 75 për qind e vëllimit të komplet projektit të decentralizimit, që po implementohet. Tani ka mbetur shumë pak në bartjen e kompetencave, është menaxhimi i pyjeve dhe kullsave, i cili po përfundon”.

Mirëpo, sipas ministrit Ferati, tani ka mbetur një punë jo e lehtë, është fjala për Mitrovicën e veriut dhe Parteshin, të cilat do ta përmbyllin procesin e decentralizimit.

Edhe pse politikisht decentralizimi mund të konkludohet se është realizuar, banorët e komunave të reja edhe për një periudhë kohore nuk mund t'i prekin produktet që sjell ky proces. "Pres që Komisioni Qendror Zgjedhor, si organ kompetent, të certifikojë shumë shpejt rezultatet për asamblatë komunale dhe kryetarët e zgjedhur. Do të jetë e mundur që brenda këtij viti kryetarët e rinj dhe asamblistët ta bëjnë betimin dhe t'i mbajnë seancat konstituive. Menjëherë, kryetari do të ketë të drejtë që ta kompletojë Bordin e drejtorëve dhe nga aty do të fillojë të kompletohet sa më parë që është e mundur administrata. Ndërkohë, ekipet përgatitore kanë bërë shumë punë sa i përket buxhetit, organogramit, statutit të komunës dhe kanë marrë shumë shënime nga komunat amë, që do të mund të përdoren menjëherë në komunën e re, në mënyrë që të jetë sa më i shkurtër tranzicioni dhe qytetarët të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur të marrin shërbime në komunat e tyre të reja".

Sipas Feratit, kompletimi i administratave në komunat e reja do të mund të ndodhë deri në fund të muajit shkurt të vitit të ardhshëm. "Deri në bartjen e regjistrave dhe shënimeve tjera, qytetarët do të mund t'i vazhdojnë shërbimet në komunat amë".

I pyetur për mundësitë e komunave të reja që të marrin donacione nga Serbia, siç e lejon Pakoja e Ahtisaarit, ministri Ferati tha se një gjë e tillë mund të ndodhë, por në përputhshmëri me ligjet e Republikës së Kosovës. "Teoritikisht ligjet e Republikës së Kosovës lejojnë komunat që të hyjnë në relacione me donatorë të ndryshëm duke përfshirë edhe ata nga Serbia. Siç dihet, ministria duhet ta japë një konfirmim në lidhje me ato investime që mund të bëhen nga vendet tjera. Po ashtu, ne nuk do të pengojmë asnjëherë investimet ku komuna është kompetente, ndërsa qarkullimi i atyre mjeteve natyrisht se duhet të ndodhë nëpërmjet bankave komerciale të Kosovës dhe ato shënime të jepen në Thesar".

Ferati paralajmëron investime të fuqishme nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorët për komunat e reja. "Do të kemi mundësi të realizojmë projekte të rëndësishme për këto komuna, të cilat do të ndikojnë në kualitetin e jetës atje dhe dalëngadalë edhe këto komuna së bashku me ato ekzistuese do të fuqizohen. Qytetarëve të komunave të reja tani u është dhënë mundësia që të kenë struktura udhëheqëse legjitime dhe ata nuk do të mund të manipulohen më nga struktura improvizuese".

Sipas Feratit, investimet që do të ndodhin dhe që po ndodhin në komunat e reja automatikisht do të eliminojnë strukturat e deritashme paralele, që kanë

funksionuar nëpër lokalitete të caktuara serbe. “Ne nuk merremi me struktura paralele, ato janë ilegale, nuk i pranojmë as ne dhe as partnerët tanë me të cilët punojmë. Vetë qytetarët serbë nuk janë të kënaqur. Shiheni, tash Serbia vetë i zhbën këto struktura, sepse ato e kanë të pamundur të funksionojnë”.

Qytetarët serbë, sipas ministrit, do të binden se strukturat paralele atyre vetëm u sjellin probleme dhe asgjë të mirë. “Unë pres që strukturat paralele do të zbehen dhe përkohësisht do të funksionojnë vetëm në arsim dhe shëndetësi në disa vendbanime me shumicë serbe, sepse administrata dhe fushat tjera menjëherë tani do të funksionojnë në kuadër të komunave të reja. Por me kohë edhe në arsim dhe shëndetësi strukturat paralele do të zhbëhen dhe perspektiva e vetme për serbët e Kosovës ,që tashmë e dinë, është vetëm barazia qytetare që u ofrohet me ligjet e Republikës së Kosovës, faktorizimi i tyre që do të menaxhojnë vetveten në pushtetin lokal dhe do të participojnë në pushtetin qendror, në Parlament dhe në Qeveri”.

Duke folur për veriun e Kosovës, ministri Ferati tha se atje tani janë dy çështje, njëra është pjesa veriore e Mitrovicës që së shpejti ai tha se presin që të instalohen ekipet përgatitore për t’i bërë përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme që duhet të organizohen dhe tjetra është çështja e Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin-Potokut, aty ku nuk ka pasur dalje të mjaftueshme në zgjedhje. “Në momentin kur atje shënohet progres i nevojshëm, ne jemi të gatshëm që atje të organizojmë zgjedhje prapë. Sidomos për pjesën veriore të Mitrovicës kjo është një ofertë. Unë po besoj dhe ka interesim që qytetarët do ta shfrytëzojnë këtë mundësi, ngaqë pikërisht ata në këtë thirren. Nuk do të ketë improvizime, por do të vlerësohet realisht se kur të jenë pjekur kushtet, që projekti të testohet dhe të japë rezultatet e veta”.

I pyetur se çka do të ndodhë me kryetarët e sapozgjedhur në komunat veriore, të cilët edhe pse në kuadër të ligjit, kanë marrë shumë pak vota dhe legjitimiteti i tyre është në pikëpyetje, Ferati tha se për këtë çështje nevojitet një analizë dhe pastaj duhet marrë një vendim. “Është një situatë jo e lehtë. Nuk kontestohen kualitetet e njerëzve që kanë fituar besimin e qytetarëve, por në përgjithësi situata është komplekse dhe kërkon një analizë më të gjerë jo vetëm tonën dhe KQZ-së, por edhe të faktorëve tjerë. Mendoj që nuk kontestohet legjitimiteti i votës, por është problem të konstatohet legjitimiteti dhe fuqia e një strukture që atje do të instalohet, posaçërisht kur dihet se ato janë struktura që kanë dalë nga vota e vetëm një komuniteti dhe atje ne kemi problemin e një bashkëjetese”.

Procesi i decentralizimit vlerësohet më 2011

Ministri Ferati tha se siç parashikohet me Pakon e Martti Ahtisaarit dhe ligjet e Kosovës, në vitin 2011 do t'i bëhet një vlerësim decentralizimit si projekt. “Do të vlerësojmë se si po funksionon decentralizimi, a duhet të ndryshohet diçka apo jo dhe pastaj do të shkojmë me fazën e dytë të decentralizimit, ku do të mund të konkurrojnë pastaj në këtë projekt të gjitha vendbanimet që përmbushin kriteret dhe mund të mbijetojnë si komuna”, tha ai.

Komunat e reja e fillojnë punën në objekte me qira

Deri në muajin shkurt të vitit 2010, sipas ministrit Ferati, udhëheqësit e komunave të reja do të akomodohen në objekte private me qira. “Për shkak se aktualisht ne nuk kemi objekte në ato vendbanime, ata përkohësisht do të vendosen në objekte me qira. Ndërsa ne i kemi siguruar mjetet dhe shumë shpejt, në fillim të vitit të ardhshëm do të fillojnë procedurat e tenderimit siç parashikon ligji dhe shpresoj se brenda vitit 2010 do të bëhet ndërtimi i objekteve për komunat e reja”, tha ai.

Intervistoi
VALMIR KLAIQI